



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-7228
Dt.17.05.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtuar nga: **Gazmend (Aziz) Canhasi**, nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt ekonomik (depo e materialit hidro sanitar) – FAZA E PARË, me etazhitet P+0 në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM



I. I LEJOHET: Gazmend (Aziz) Canhasi, nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt ekonomik (depo e materialit sanitar), Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore, me nr.07-351-47348, dt.18.01.2017 të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 32/1, ZK: Zidi i Sadik Agës II, në pronësi të lartpërmendurit, në rrugën “Pjeter Bogdani”, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+0, në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit prej **S=491.06 m²**

Përdhesa: (Sip,Bruto): S=491.06 m²

I. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim - objekt ekonomik (depo e materialit sanitar), nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese “ALBA CONARK”. - Gjakovë.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

III. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Gazmend (Aziz) Canhasi, nga Gjakova, me banim në rrugën “Washingtoni”, pn, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-7228, dt.31.03.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt ekonomik (depo e materialit hidro sanitar) – FAZA E PARË, me etazhitet P+0, në ngastrën kadastrale me nr. 32/1, ZK: Zidi i Sadik Agës II, në pronësi të lartpërmendurit, në rrugën “Pjeter Bogdani” siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1 000 , të datës 15.11.2016, i punuar nga NSH” Geogauss”- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 03.02.2017, në pronësi të Gazmend (Aziz) Canhasi të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 479/17, të datës 08.02.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Lejen Mjedisore Komunale, me nr.07-351/4510, dt.04.04.2017, të lëshuar nga DUMM.
5. Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit banimor shumë banesor në ngastrat kadastrale me nr. 16-4,16-22,18-2,19-3,19-17,20-6 dhe 20-21, ZK: Zidi i Sadik Agës, të datës 04.10.2016.
6. Vendimin për Kushte Ndërtimore, me nr.07-351-47348, dt.18.01.2017, në ngastrën kadastrale me nr. 32/1, ZK: Zidi i Sadik Agës II.
7. Pëlqimin Sanitar, me nr 14/530/01-7231, të datës 14.04.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese.
8. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320-01-6346, dt.27.03.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-b-465 të datës 13.03.2017.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 20.02.2017.
11. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.-Gjakovë, nr.326, të datës 31.01.2017.
12. Pëlqimin nga PTK-Sh.A. Gjakovë, të datës 30.01.2017.
13. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filjala në Gjakovë, të datës 16.05.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja projektuese “ALBA CONARK”. - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1262.02 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.


U. D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË

PLAN SITUACIONI

Z. kad. Zidi i Sadik Agës
Parcela nr. 32-1




— Gjendja Nadashtake
— Gjendja Faktike

Gjakovë;
18.01.2017

Punoi:
Fatmir Babi tek.

Vërteton urb.
Dumrije Berisha I.D.A.



Is. Nënlor, 2016 m.
Shënimet hwytye
Auto CAD 2004

P = 1 : 1 000

Punoi: N.SH. "Geognus" Gjakovë
DREJTORI
Mehdi Sivani gjeom.